

Konfiskohet një armë zjarri në Shtime, Policia jep detaje për rastin



05/02/2023 20:55

f

t

l

Policia e Kosovës në rajonin e Shtimes ka pranuar sot një informacion se në rrugën “Shote Galica”, një person posedon armë zjarri në shtëpinë e tij.

Me të marrë informatën, Policia ka marrë veprimet e nevojshme dhe nën autorizim të prokurorit kujdestar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, kanë shkuar në shtëpinë e personit të dyshuar B.M, i moshës 62 vjeçar, i cili ka pranuar se posedon një armë zjarri, të cilën më pas policia e ka konfiskuar.

“I dyshuari, është shoqëruar në stacionin e policisë në Shtime dhe pasi është intervistuar nga hetuesit policor, me vendim të prokurorit, i njëjti është liruar për procedurë të rregullt hetimore”,thuhet në njoftimin për media./Lajmi.net/



Artikuj të ngjashëm

- February 6, 2023

Greqia lë anash konfliktin me Turqinë pas tërmetit: Po nisemi të...
- February 6, 2023

LAJMI I FUNDIT: Tjetër tërmet shumë i fuqishëm godet Turqinë
- February 6, 2023

Çka po ndodhë? Ambasadorët e QUINT-it i shkojnë në zyre Kurtit
- February 6, 2023

Kryeministren serbe “e rrokë” pagjumësia nga sikleti, kërkon falje pse Kosova...
- February 6, 2023

Shkon në 912 numri i viktimave nga tërmeti në Turqi
- February 6, 2023

“Super Puna” – Qeveria synon t’i hap 10 mijë vende pune